



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.316, datë 02.12.2022

PËR

“MIRATIMIN E PLANIFIKIMIT TREMUJOR TË VLERËSIMIT ETIK DHE
PROFESIONAL INDIVIDUAL TË 20 (NJËZET) PROKURORËVE, PËRGJATË VITIT
2023”

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës, nenet 159, pika 2, germa “a” dhe “e”, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “c”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 68, 84, 85 dhe 97, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në Rregulloren “Për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën me 20 (njëzet) prokurorë, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional individual i tyre, përgjatë vitit 2023, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore dhe Prokurorët e komanduar pranë Këshillit pjesë e kësaj njësie, për ndjekjen e këtij procesi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 02.12.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti